



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Përmbledhje

Takimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave

Datë: 31 Janar 2024

Koha: 09:00-15:30

Me datë 31 janar 2024 u mbajt takimi vjetor i Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP). Takimi u drejtua nga Kryesuesi i Këshillit z. Dardan Fusha, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Përveç anëtarësisë së zgjeruar të KKP-së, përfshirë drejtuesit e bankave dhe institucioneve financiare jo-bankare, në këtë takim morën pjesë edhe Guvernatori i Bankës Qendrore z. Ahmet Ismaili dhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve z. Hekuran Murati, me nga një fjalë përshëndetëse në hyrje të takimit, përfaqësues nga Institucionet Qeveritare (ATK, ARC, ASHI, MINT) dhe përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Zyra e BE-së, SECO, si dhe Skemat Ndërkombëtare të Kartelave Visa dhe Master Card.

Takimi u hap nga Kryesuesi i KKP-së z. Fusha, i cili në fjalën e tij hyrëse, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë takim me rëndësi për ri-funksionalizimin të KKP-së me një përfshirje të zgjeruar të anëtarësisë të nivelit drejtues, si organ këshillues për Bankën Qendrore dhe të gjitha institucionet anëtare, me qëllim rritjen e bashkëpunimit lidhur me zhvillimet e reja, standardizimin dhe sigurinë e sistemit dhe shërbimeve të pagesave, në një moment shumë të rëndësishëm të reformave në kuadrin ligjor dhe në infrastrukturën teknike, të ndërlidhura edhe me objektivat drejtë integritimit me sistemet e pagesave të BE-së, dhe rajonin.

Në vazhdim z. Fusha i kaloi fjalën Guvernatorit z. Ismaili për një fjalim rasti dhe përshëndetje për të pranishmit, me që rast z. Ismaili theksoj rëndësinë e kësaj ngjarje e cila ka për qëllim:

- Riorganizimin dhe funksionalizimin e Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP), përkatësisht, zgjerimin e anëtarësisë së KKP-së si një organ këshillimor në mbështetje të reformave në fushën e pagesave dhe rritjes së sigurisë së Sistemit Kombëtar të Pagesave;
- Përditësimin mbi zhvillimet e infrastrukturës ligjore dhe teknike në fushën e pagesave sikurse janë zhvillimet në proceset dhe planet për avancimin e kuadrit ligjor dhe infrastrukturës teknike të sistemit dhe shërbimeve të pagesave; dhe
- Përcaktimin e një plani kombëtar për përfshirjen financiare dhe reduktimin e përdorimit të parave të gatshme, ku aktivitetet e palëve të interesuara do të përcaktohen dhe dakordohen për rritjen e qasjes në dhe përdorimit të llogarive të pagesave dhe instrumenteve të pagesave elektronike dhe reduktimin e parasë së gatshme, me qëllim uljen e kostos së shërbimeve të pagesave për rrjedhën më efikase të transaksioneve si dhe efekteve të tjera pozitive në ekonomi.

Guvernatori, u shpreh se një sistem i shëndoshë dhe efikas i pagesave, në sistemin financiar të Republikën e Kosovës mbështetë zhvillimin e mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar dhe rritjen e stabilitetit financiar, duke krijuar kështu një klimë në të cilën investitorët mund të zgjerojnë bizneset e tyre, me ndikim pozitivë në tregtimin e mallrave dhe shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve përmes një qasje më të lehtë. Gjithashtu, një sistem i zhvilluar i pagesave siguron zvogëlimin e efekteve negative dhe siguron integritet në sistemin financiar të vendit.

Më tej Guvernatori shtoi se avancimi i sistemit të pagesave do të përshpejtoj qasjen e Republikës së Kosovës në Zonën e Vetme të Pagesave të Bashkimit Evropian, të njohur si SEPA dhe Sistemin e Pagesave të Shpejta të Bashkimit Evropian, i njohur si TIPS, si objektiv strategjik i BQK-së. Duke përmendur Planin Strategjik 2024-2028 të BQK-së, Guvernatori listoi disa nga aktivitetet që janë planifikuar dhe që lidhen me fushën e sistemit të pagesave si dhe renditi disa nga veprimet tashmë të ndërmarra në aspektin rregullativ dhe ligjor, si përgatitje drejt zbatimit të Planit si:

- Avancimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike të BQK-së për anëtarësim në Skemën e Pagesave SEPA dhe qasje në Sistemin e Pagesave të Shpejta të BE (TIPS);
- Zhvillimi i infrastrukturës teknike për mundësimin e pagesave të shpejta 24/7, krijimi i QR Kodit kombëtar dhe standardizimi i API-së për ndërlidhje të sistemeve;
- Reduktimi i pagesave me para të gatshme si dhe promovimi i pagesave elektronike;
- Krijimi i mundësive për qasjen në sistemin e pagesave të ofruesve të shërbimeve jo-bankare, si dhe mundësimi i posedimit të IBAN-it, për të rritur qasjen në financa, në kuadër të konceptit të "llogarisë për pagesa", ku kemi miratuar rregulloren,
- Ri-funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave;

Në përmbyllje të fjalimit të tij, Guvernatori u shprehë se duke qenë se KKP tashmë është zgjeruar, dhe ka një përbërje që reflekton edhe sistemin financiar dhe ekonominë në tërësi, konsideroj se kemi një mundësi që të koordinojmë qasjen, aktivitetet dhe politikat për të arritur një zhvillim që në mënyrë substanciale ndërron situatën, na sjell në një nivel të ri, dhe shumë më afër me objektivin tonë të përafritimit me BE.

Pas Guvernatorit kryesuesi i kaloi fjalën Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve z. Hekuran Murati. Në fjalën përshëndetëse të tij, z. Murati përmendi një sërë projektesh të ndërmarra, të cilat mbështesin digjitalizimin e shërbimeve qeveritare dhe formalizmin e ekonomisë.

Ministri Murati theksoj se takimet si ky i KKP-së, janë një mundësi e mirë për të ecur përpara sa i përket digjitalizimit të shërbimeve të pagesave apo thënë ndryshe reduktimit të parasë së gatshme, marrë parasysh nevojën e adresimit të aspekteve të ndryshme që ndikojnë në këtë çështje. Sipas Ministrit Murati, përfitimet e digjitalizimit do e zvogëlojnë barrën administrative, pastaj koston e operimit, duke rritur integritetin dhe sigurinë e çdo transaksioni. Kjo ndikon edhe në evitimin e rreziqeve, siç është çështja e parave fals, por edhe e parandalon financimin e aktiviteteve ilegale.

Tutje, Ministri Murati përmendi edhe disa nga projektet që janë zhvilluar nga qeveria, si ajo EDI dhe produkte të tjera ose masa të tjera, si p.sh masat për shtesat e fëmijë ku përfitojnë rreth 400 mijë fëmijë të cilat kryhen krejtësisht në forme digjitale kjo si rezultat i bashkëpunimit me BQK-në, ku është mundësuar verifikimi i llogarive të përfituesve, i tërë ky proces është mundësuar të realizohet në mënyrë automatike.

Ministri Murati theksoj se sa i përket reduktimit të parasë gatshme, Ligji për ATK i cili tashmë është në fuqi, i miratuar vitin e kaluar, parasheh disa mekanizma ose instrumente të reja të cilat kanë synim reduktimin e parasë së gatshme dhe orientimin drejt transfere digjitale.

Ministri Murati përmendi dhe bashkëpunimin që ka Ministria me Bankën Botërore në fushën e digjitalizimit të pagesave. Megjithatë, si sfidë për pagesat digjitale Ministri Murati paraqiti edhe çështjen e operatoreve ekonomik, të cilët fillimisht kanë një kosto relativisht të lartë për një transaksion, si dhe aktualisht vëllimi i pagesave digjitale është në nivel jo të mjaftueshëm. Një barrierë tjetër mbetet edhe kostoja e lartë për transaksion sidomos tek bizneset e vogla, ku një pjesë të marzhës së fitimit do të duhet ta ndajnë me institucionet që ofrojnë shërbime të tilla.

Në përmbyllje të fjalimit përshëndetës Ministri Murati, tha se si qeveri kemi vullnet që këto procese t'i shtyjme dhe ti mbështesin në mënyrë që të ecim me hapa konkret në zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme, me qëllim edhe të luftimit të informalitetit duke rritur mundësinë dhe efikasitetin e shërbimeve digjitale.

Pas fjalimeve përshëndetëse nga Guvernatori z. Ismaili dhe Ministri z. Murati, fjalën e mori për një prezantim Zëvendësguvernatori z. Fusha, i cili falënderoj z. Murati për shpалosjen e planeve të ministrisë për digjitalizimin e shërbimeve, të cilat ndërlidhen ngushtë me strategjinë dhe objektivat për modernizimin e sistemit të pagesave, në ndërtimin e një sistemi që i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të tregut dhe ekonomisë së vendit, duke shprehur njëkohësisht se mbështetja e Ministrisë për këto reforma është e një rëndësie të veçantë dhe e domosdoshme për arritjen e objektivave të përbashkëta.

Z. Fusha, në cilësinë e kryesuesit vazhdoi me moderimin e këtij takimi, duke prezantuar fillimisht disa nga zhvillimet kryesore në proces, si dhe planet afatshkurta dhe afatmesme të BQK-së lidhur me avancimin e sistemit të pagesave, ku ndër të tjera shpалosi më hollësisht çështjet si:

- Ri-organizimi dhe funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP); Udhëzimi i rishikuar i KKP-së, përbërja, kompetencat dhe detyrat e KKP-së, përfshirë krijimin e grupeve punuese të niveleve teknike si mekanizëm për zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve.
- Zhvillimet në infrastrukturën ligjore, me fokus finalizimin e Ligjit për shërbimet e pagesave dhe rishikimi i kornizës rregullative që derivon nga ky Ligj, duke paraqitur përparësitë e tij për tregun e pagesave, rritjen e konkurrencës, avancimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurisë së shërbimeve të pagesave, mundësimin e bankingut të hapur dhe identifikimin e avancuar të klientëve, si dhe përmbushjen e kriterëve për integrimet në sistemet e BE-së.
- Projektin e Komisionit Evropian të administruar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal nën implementimin e Bankës Botërore, me qëllimet kryesore: Përmbushja e kriterëve ligjore dhe teknike për anëtarësim në SEPA dhe qasje në TIPS.
- Zhvillimet në infrastrukturën teknike, me fokus Implementimi i Sistemit të Pagesave të Shpejta, të njohura si Instant Payments dhe avancimi i qasjes indirekte të IFJB-ve në sistemin e pagesave ndërbankare, përmes rregullores së re për pajisjen e të gjithë ofruesve të shërbimeve të pagesave (përfshirë IFJB-të) me IBAN, si dhe standardizimi i QR kod-it, si mekanizëm lehtësues në procesin e pagesave;

Z. Fusha shpалosi detaje të Studimit të Kostos së Pagesave me Vlerë të Vogël dhe Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël, të dy këto projekte të realizuara me mbështetjen e Bankës Botërore në kuadër të Programit për Pagesat dhe Remitancat të sponsorizuar nga SECO.

Kryesuesi z. Fusha e mbylli prezantimin e tij duke theksuar se këto veprime dhe zhvillime të nevojshme për avancimin e sistemit të pagesave, paraqesin edhe sfida të konsiderueshme, si nga perspektiva e BQK-së ashtu edhe nga perspektiva e bankave dhe institucioneve financiare jo-bankare, prandaj kërkohet një bashkëpunim dhe koordinim më i madh. Meqë kërkohen investime në infrastrukturë dhe kapacitete për të arritur standardet e BE-së dhe për ofrimin e shërbimeve 24/7 siç janë pagesat e shpejta. Gjithashtu, edukimi financiar do të jetë në fokusin e BQK-së, për çfarë kërkohet një bashkëpunim më i gjerë me të gjithë anëtarët e Këshillit, krahas avancimit të praktikave të tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve, duke marr parasysh paraqitjen e shërbimeve të reja në formë digjitale. Prandaj, do të organizohen dhe mbështetën kampanja për edukimin financiar të përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përfitimet, mënyrën e realizimit, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike.

Takimi vazhdoj me një fjalim nga z. Ilir Murtezaj, Drejtor në Administratën Tatimore të Kosovës, i cili shprehu përkushtimin e ATK-së në digjitalizimin e shërbimeve të pagesave si proces me rëndësi të madhe për ekonominë e vendit, në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve dhe uljes së informalitetit. Gjithashtu, beri thirrje për ndërlidhjen e sistemeve në mes të institucioneve, duke dhënë mundësinë bankave komerciale që përmes BQK-së të shfrytëzojnë të dhënat e Pasqyrave Financiare që bizneset raportojnë në formë elektronike në ATK. Ndërlidhja e këtyre sistemeve do të krijonte mundësi për rritje të kualitetit të të dhënave që raportohen në Pasqyra Financiare, si dhe do të kemi rritje të sigurisë për palët e interesit si ATK-në, Bankat Komerciale dhe Bizneset. Z. Murtezaj shprehu përkushtimin dhe gatishmërinë e ATK-së për zhvillim sa i përket fushës së digjitalizimit në përkrahje të shërbimeve online dhe digjitale dhe fushat e ndërveprimit për arritjen e synimeve të përbashkëta në nivel vendi.

Pjesa e parë e panelit vazhdoj me prezantimin e z. Holti Banka, Specialist i lartë i sektorit financiar në Bankën Botërore, ku si pjesë të prezantimit kishte rrugën integruese të Kosovës drejt anëtarësimit në SEPA dhe kriteret ligjore dhe teknike. Prezantimin e vazhdoj duke përfshirë dhe kornizën ligjore e cila duhet plotësuar, si dhe me fokus tek benefitet që vijnë si rezultat i integritimit në SEPA, në funksion të uljes së kostos dhe kohës së kryerjes së pagesave me BE-në dhe rajonin. Gjithashtu, si pjesë të prezantimit z. Banka, paraqiti edhe detaje lidhur me pagesat e shpejta apo ndryshe siç njihen “Instant Payments” dhe përparësive që sjellin për tregun e pagesave.

Pas z. Banka, fjala iu dha z. Suat Bakkal, Kryesues i Bordit në Shoqatën e Bankave të Kosovës. Z. Bakkal iu drejtua të pranishmeve duke theksuar se Bankat janë të përkushtuara për të mbështetur iniciativat dhe zbatimin e rregulloreve që synojnë formalizimin e ekonomisë dhe kalimin drejt pagesave dixhitale duke reduktuar përfundimisht informalitetin ekonomik. Formalizimi i ekonomisë nuk është thjesht një përpjekje burokratike, por është një katalizator për akses më të madh në shërbimet financiare për popullsinë që aktualisht nuk kanë qasje në banking.

Ndër të tjera z. Bakkal theksoj se bankat janë të përgatitura për të udhëhequr këtë evolucion digjital, ku kanë investuar në mënyrë të konsiderueshme në zgjidhje të avancuara në lidhje me Luftimin e Pastrimit të Parave (AML), sigurinë kibernetike dhe mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave. Tuje z. Bakkal, vuri në pah edhe përdorimin e POS terminaleve nga tregtarët, për të krijuar stimuj për t'i nxitur tregtarët që t'i përdorin.

Si përfundim z. Bakkal, tha se gatishmëria e ofruesve të shërbimeve të pagesave në kuadër të zhvillimeve të reja ligjore dhe infrastrukturore është një hap vendimtar drejt ndërtimit të një ekonomie dixhitale të fuqishme dhe dinamike. Bankat jo vetëm që janë të përkushtuara ndaj këtij transformimi, por janë të pajisura edhe me mekanizmat e nevojshëm për të udhëhequr këtë zhvillim.

Pjesa e parë, u përmbyll me prezantimin e z. Lumni Rrustolli, Drejtor në Departamentin e Sistemit të Pagesave në BQK, i cili shpalosi disa të dhëna mbi infrastrukturë aktuale operacionale të sistemit të pagesave ndërbankare, si dhe të dhëna statistikore lidhur me instrumentet dhe shërbimet e pagesave, përfshirjen financiare, zhvillimin e infrastrukturës së pagesave dhe trendëve të transaksioneve përmes instrumenteve të pagesave elektronike, si:

- Të dhëna mbi instrumentet e pagesave, терминаlet e pagesave (ATM, POS, POS VIRTUAL) dhe përdorimin e tyre, me fokus pagesat me kartela dhe instrumentet e pagesave elektronike.
- Efektet e Rregullores së Llogarive të Pagesave me Shërbime Bazike, në rritjen e qasjes në llogari dhe përfshirjen financiare.
- Fushata për përdorimin e pagesave me kartela; Roli i institucioneve dhe ndarja e detyrave ndërmjet tyre;

Nga të dhënat e prezantuara, vërehet çartë një rritje e vazhdueshme e përdorimit të shërbimeve dhe instrumenteve të pagesave të bazuara në teknologji digjitale, si: rritja e numrit të pagesave të realizuar në POS terminale me një mesatare mbi 40% në dy vitet e fundit, rritja e numrit të pagesave me para elektronike rreth 100% në vitin e fundit, e si rezultat i kësaj një rritje e përdorimit të instrumenteve jo në para të gatshme, nga ku është arritur që brenda vitit 2023 mesatarja e transaksioneve jo në para të gatshme për kokë banori të jetë 35.2 pagesa, një tejkalim i parashikimit në kuadër Strategjisë Kombëtare për Pagesa me Vlera të Vogla, e cila ka pasur synim që deri në vitin 2026 kjo mesatare të jetë 25 pagesa. Nga të dhënat e paraqitura, gjithashtu theksohet rritja e përdorimit të numrit të kartelave me funksion debiti dhe kartelave me funksion paranë elektronike, e cila në tërësinë e saj konfirmon digjitalizimin e shpejtë të shërbimeve të pagesave në vend dhe zvogëlimin e përdorimit të parasë së gatshme për pagesa.

Një e dhënë tjetër e rëndësishme është rritja e përfshirjes financiare në vend, përmes të dhënave të paraqitura mbi numrin e llogarive, e sidomos rritja e përdorimit të llogarive për shërbime të e-banking-ut, me një rritje mesatare mbi 25% në dy vitet e fundit, por gjithashtu edhe efekti i Rregullores për qasje në llogari pagese me shërbime bazike, nga ku mbi 320 mijë llogari janë konvertuar në llogari bazike dhe poseduesit e këtyre llogarive mund ti marrin shërbime bazike pa pagesë.

Pjesa e dytë:

Pjesa e dytë filloj me prezantimin e znj. Oya Pinar Ardic Alper, Specialiste e lartë e sektorit financiar në Bankën Botërore, e cila paraqiti projektet e Bankës Botërore në vende të ndryshme në mbështetje të pranimit të pagesave elektronike. Si pjesë të këtij prezantimi kishte edhe detaje dhe faktorë konkret që ndikojnë në rritjen e qasjes në shërbimet e pagesave elektronike, duke elaboruar shembuj të vendeve tjera dhe iniciimin e projektit të ngjashëm në Kosovë. Ky projekt parashihet të zhvillohet paralelisht me iniciativën e BQK-së dhe anëtarëve të Këshillit për reduktimin e përdorimit të parave të gatshme, i cili do jetë një mbështetje e rëndësishme e aktiviteteve që do të ndërmerren përmes Grupit punues ndër institucional që do të themelohet për këtë qëllim.

Pas znj. Pinar, fjala iu dha z. Petrit Balijs, Drejtor Ekzekutiv në Shoqatën e Bankave të Kosovës, ku paraqiti një vështrim rreth avancimit të shërbimeve në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave me kartela dhe instrumenteve tjera elektronike. Ndër të tjera z. Balijs tha se duhet të ketë një ligj më të zbatueshëm dhe se institucionet financiare të jenë atraktive në shërbimet që i ofrojnë.

Pas z. Balijs, fjalën e morën përfaqësuesit e Institucioneve financiare Jo Bankare, znj. Eda Shaqiri dhe z. Gazmend Selmani, ku folën rreth avancimit të shërbimeve në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave me para elektronike dhe rolin dhe kontributin e këtij sektori.

Në vazhden e sesionit të dytë, fjalën e mori për një prezantim znj. Snezana Sofijanic, përfaqësuese e Visa-së, e cila prezantoi promovimin e përfshirjes financiare dhe minimizimin e përdorimit të parasë së gatshme. Gjithashtu prezantoi edhe disa shembuj të vendeve të ndryshme për kampanja të reduktimit të parasë së gatshme, duke elaboruar kontributin që ka dhënë Visa në këto raste.

Prezantimi vazhdoi tutje, nga znj. Silvia Hadzhiyaneva, përfaqësuese e Mastercard, e cila prezantoi shembuj të vendeve tjera dhe zgjidhjet e avancuar, në funksion të rritjes së përdorimit të pagesave dhe terminaleve me kartela. Znj. Hadzhiyaneva paraqiti disa forma të bashkëpunimeve ndër-institucionale dhe mbështetjes së ofruar nga MC në këto raste, ku si faktor të rëndësishëm ngriti nevojën e veprimeve të përbashkëta të gjitha institucioneve, përmes rregullimit, incentivave dhe edukimit, në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritura.

Pjesa e tretë:

Në pjesë e tretë të takimit u prezantuan konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga ky takim, në fokus të veçantë rekomandimet për reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe mundësimin e pagesave elektronike, si dhe rekomandimet për krijimin e grupeve punuese lidhur me projektet në vazhdim për zhvillimet e infrastrukturës ligjore dhe teknike në fushën e pagesave, në funksion të proceseve integruese të vendit, avancimit të shërbimeve digjitale dhe rritjes së përfshirjes financiare. Pas diskutimeve me mundësinë e kontributit dhe paraqitjes së qëndrimeve nga të gjithë të pranishmit¹, si përfundim u nxjerrën edhe konkluzionet si në vazhdim:

¹ "Të gjithë pjesëmarrësit janë njoftuar që ky takim nuk përmban ndonjë informacion konfidencial dhe nuk janë shpalosur informata direkte apo jo-direkte për konkurrencën, në pajtim me rregullat e përcaktuara me legjislacionin mbi konkurrencën.

1. Anëtarët e KKP-së u pajtuan me krijimin e Grupit Punues për Reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme dhe rritjen e përdorimit të pagesave elektronike, dhe ndarjen e detyrave dhe ndjekjen e hapave përmes rekomandimeve të cilat janë paraqitur si ne vazhdim:

BQK

- *Udhëheq Grupin Punues për Reduktimin e Parasë së Gatshme;*
- *Koordinon punën e grupit me institucionet tjera relevante;*
- *Rishikon dhe përgatit kornizën rregullative në mbështetje të avancimit dhe përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike;*
- *Funksionalizon pranimin e pagave dhe skemave tjera në llogarinë e pagesave të IFJB, përmes ofrimit të IBAN dhe qasjen e tyre në sistemin kombëtar të pagesave;*
- *Standardizon/krijon standardin e QR Code kombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi, të cilat lejojnë ndërveprim me opsione të ndryshme pagese, si dhe mbështet ndërlidhjen e sistemit të shitjes/arkave fiskale/platformës universale të shitjes me ofruesit e shërbimeve të pagesave;*
- *Avancon infrastrukturën teknike për procesimin dhe shlyerjen e pagesave elektronike përmes ndërtimit të një sistemi të ri të procesimit të pagesave të shpejta;*
- *Organizon dhe mbështetë fushatën për edukimin financiar të përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përfitimet, mënyrën e realizimit, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Thesari i Kosovës

- *Organizon dhe mbështetë fushatën për edukimin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përfitimet, mënyrën e realizimit, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike;*
- *Përmirëson infrastrukturën digjitale që institucioneve publike t'u krijohet mundësia e pranimin të pagesave për shërbimet publike fizikisht përmes përdorimit të kartelave dhe instrumenteve tjera të pagesave elektronike (krahas shërbimeve në platformën e-Kosova);*
- *Njohja e vlefshmërisë së dëshmisë së pagesave përmes e-banking, e-commerce, POS nga institucionet shtetërore (si të barasvlershme me dëshminë e pagesës fizike në zyrat e OSHP-ve);*
- *Avancimin e infrastrukturës teknike (në platformën e-Kosova apo sistem tjetër qeveritar) për ndërlidhje me sistemin e ri të pagesave të shpejta;*
- *Shqyrton mundësinë e ndërmarrjes së hapave shtesë që lidhen me përdorimin e reduktuar të parasë së gatshme, në funksion edhe të luftimit të ekonomisë jo-formale, si shembull përmes:*
 - *Një sistemi kontrolli për pagesat në para të gatshme mbi një shumë të caktuar nga ana e qytetarëve/bizneseve, p.sh. siç është për bizneset shuma prej 2,500-3,000 euro (si fillim), të konsiderohet vendosja e një limiti për bizneset në rastin e shitjeve (ngjashëm me kufizimet për furnizimet nga biznesi, tash me limit të ri 300 euro – nga 500 sa ishte);*
 - *Kufizimet me rastin e pranimin të pagave nga punësimi në sektorin privat – një pjesë e konsiderueshme e punëtorëve në këtë sektor nuk marrin fare pagesa përmes kanaleve bankare ose financiare;*
 - *Avancimi i arkave fiskale që mundësojnë integrimin me POS terminalët dhe unifikimin e faturimit elektronik ose zgjidhje alternative e unifikuar;*

- *Krijimi i profilit tatimor (raportit tatimor) individual për çdo blerës, ose platforme shitjeje universale, që të stimulojë marrjen e kuponit tatimor dhe eventualisht ndonjë incentivë fiskale në TVSH për blerjet vjetore të bëra dhe paguara me karta;*
- *Shqyrton mundësinë e stimulimit të kërkesës përmes programeve të ndryshme nxitëse, në bashkëpunim me BQK dhe industrinë financiare;*

Bankat dhe IFJB-të

- *Unifikimi i POS terminaleve sipas zhvillimeve të tregut dhe integrimi/unifikimi në arkën fiskale me mbështetje të autoriteteve përkatëse të shtetit;*
- *Përmirësimi i kushteve kontraktuale, për rritjen e efikasitetit dhe ofrimin e mbështetjes më të madhe për tregtarët, me fokus tregtarët më të vegjël;*
- *Përdorimi i formave të reja të pranimit të pagesave elektronike, përmes Soft POS, QR Code;*
- *Avancimi i infrastrukturës në drejtim të adaptimit të sistemit të pagesave të shpejta, përfshirë kontributin në ndërtimin të një sistemi të tillë në bashkëpunim me BQK dhe akterët tjerë;*
- *Ofrimi i shërbimit të pranimit të pagesave elektronike për kompanitë e ofrimit të shërbimeve publike, transportin publik dhe institucionet qeveritare, si përmes POS terminaleve edhe përmes e-banking dhe e-commerce sipas fizibilitetit të rasteve;*
- *Organizimi dhe mbështetja e fushatave për edukimin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me përfitimet, mënyrën e operimit, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale/elektronike;*

VISA / MC

- *Organizon dhe mbështetë fushatën për edukimin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave*
- *Zotohen të punojnë me industrinë në gjetjen e zgjidhjeve për rritjen e pikave të pranimit të pagesave elektronike në Kosovë përmes iniciativave të ndryshme dhe investimeve të mundshme në treg;*
- *Zotohen të punojnë me BQK dhe institucionet tjera në ndarjen e përvojave nga vendet tjera për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete të cilat do të kontribuojnë në rritjen e pikave të shitjes dhe nxitjen e përdorimit të pagesave elektronike (jo-kesh);*
- *Lehtësimi i qasjes së bankave dhe IFJB-ve në shërbime të reja, si soft POS, virtual POS, P2P, P2B, P2G.; etj.;*
- *Mbështetja e fushatave përmes kontributit në subvencionimin e POS terminaleve për bizneset;*
- *Mundësimi i kliringut dhe shlyerjes më të shpejtë të transaksioneve të pagesave me kartela, në një afat sa më optimal;*

Institucionet tjera qeveritare si ARBK, ARC, ASHI, ATK:

- *Vendosja e pikave të shitjes (POS terminallet) nëpër institucionet shtetërore për pagesa me kartela dhe gjetja e zgjidhjeve teknike për identifikimin e pagesave të kryera në POS;*
- *E-Kosova – të avancohet infrastruktura e platformës ekzistuese përmes adaptimit të aplikacionit për mobil, përmes mundësimin të formave tjera të pagesave dhe të zgjerohet numri i shërbimeve që ofrohen përmes këtij portali;*

- *Mundësia e qasjes së bankave/IFJB-ve në data bazën e regjistrit civil (ARC), në një format të pranueshëm, në mënyrë që të konfirmohet identiteti i klientëve do rriste efikasitetin e shërbimeve;*
- *Zbatimi i plotë i kërkesave të legjislacionit për nënshkrimin elektronik për të mundësuar identifikimin elektronik të klientëve;*
- *Incentiva tatimore ose tjera për bizneset dhe për qytetarët të cilët kryejnë pagesa përmes kartelave apo kanaleve tjera elektronike (ngjashëm me rastin e kuponëve fiskal);*

Oda Ekonomike e Kosovës/Përfaqësuesit e biznesit/Shitësit me Pakicë

- *Organizojnë dhe mbështetë fushatën për edukimin e bizneseve/përdoruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me mënyrën, sigurinë dhe rëndësinë e pagesave digjitale;*
- *Edukimi lidhur me koston e parasë së gatshme dhe kursimet përmes përdorimit të pranimit të pagesave në formë elektronike;*
- *Roli këshillues për rëndësinë e furnizimit me para të gatshme nëpërmjet bankave për të evituar paratë e falsifikuara dhe nxitja e përdorimit të kartelave dhe formave tjera të pagesave elektronike;*
- *Nxitja e përdorimit të e-Commerce nga ana e bizneseve, si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në mundësimin e e-Commerce, si investimi në uebfaqe/siguri, dërgim të mallrave te klienti, etj.;*
- *Incentiva për konsumatorët që përdorin instrumente elektronike të pagesave.*

2. Anëtarët e KKP-së u pajtuan gjithashtu me krijimin e grupeve punues për zhvillimet e infrastrukturës ligjore dhe teknike në fushën e pagesave, në funksion të proceseve integruese të vendit, avancimit të shërbimeve digjitale, rritjes së përfshirjes financiare, etj. Grupet punuese do të jenë të ndara sipas projekteve dhe natyrës së punëve, të paraqitura si në vazhdim:

- **Ngritjen e funksioneve (Upgrade) të sistemit aktual KIPS, në të cilin do të përfshihen pjesëmarrësit direkt në këtë sistem si: BQK, Bankat dhe Thesari i Kosovës.**
- **Harmonizimin e direktivave të BE-së për anëtarësim në SEPA, institucionet e përfshira: BQK, MFPT dhe institucionet tjera të ndërlidhura me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizimit financiar, mbrojtjen e të dhënave personale, etj., varësisht sipas nevojës.**
- **Implementimin i Ligjit për Shërbime të Pagesave: BQK, Bankat, Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave Jo-Banka.**
- **Pranimi i Kosovës në platformat ndërkombëtare të pagesave online, si: PayPal, GooglePay, etj; BQK, Bankat, Ministrinë përkatëse.**
- **Implementimin e sistemit Instant Payment: BQK, Bankat, Thesari i Kosovës, Ofrues tjerë të Shërbimeve të Pagesave.**

BQK, në kuadër të fushëveprimit të saj, do të merr rolin koordinues për krijimin e këtyre grupeve punuese dhe ndarjen e detyrave në funksion të realizimit të qëllimeve për secilin grup.

Pjesëmarrja në mbledhje.

Të ftuar në mbledhjen e KKP		
Institucioni	Emri	Pozicioni
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Ahmet Ismaili	Guvernator
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	Z. Hekuran Murati	Ministër
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Bashkim Nurboja	Kryesues i Bordit të BQK-së
USAID	Z. Alexander Albertine	Drejtor i Zyrës për Zhvillim Ekonomik (USAID)
Zyra e EU-së në Kosovë	Z. Johannes Stenbaek Madsen	Shef i Sektorit të Bashkëpunimit-zyra e EU në Kosovë
Ambasada e Zvicrës në Kosovë	Znj. Arjeta Lleshi	Zyrtare e Lartë e Programit Kombëtar

Anëtarët e KKP		
Institucioni	Emri i Anëtarit	Statusi në KKP
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Dardan Fusha <i>Zëvendësguvernator për Operacionet Bankare</i>	Kryesues
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Lumni Rustolli <i>U.D. Drejtor i departamentit të infrastrukturës së tregut dhe pagesave</i>	Zv. Kryesues
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Blerim Terziqi <i>U.D. Drejtor i departamentit të Mbikëqyrjes bankare</i>	Anëtar
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Elvin Mala <i>Mbikëqyrës i lartë Bankar i sistemeve të informacionit</i>	Anëtar

Banka Qendrore e Kosovës	Z. Amir Zylfiu <i>U.D. Shefi i kabinetit të guvernatorit</i>	Anëtar
Thesari i Kosovës/MFPT	Z. Nysret Koca <i>U.D. Drejtor i Përgjithshëm</i>	Anëtar
Shoqata e Bankave të Kosovës	Z. Suat Bakkal <i>Kryetari i Bordit të SHBK</i>	Anëtar
Shoqata e Bankave të Kosovës	Z. Petrit Balija <i>Drejtori Ekzekutiv i SHBK</i>	Anëtar
Shoqata e Bankave të Kosovës	Znj. Akile Cernobregu-Hashani <i>Kryesuese e komitetit të pagesave</i>	Anëtare
²IFJB-Institucionet e Pagesave	Znj. Eda Shaqiri	Anëtar
IFJB-Institucionet e parasë Elektronike	Z. Gazmend Selmani	Anëtar
Banka Qendrore e Kosovës	Znj. Valmira Halili <i>Sekretare e KKP-së</i>	Anëtare
Shoqata e Bankave të Kosovës	Znj. Blendina Llabjani <i>Sekretare e KKP-së</i>	Anëtare
ATK	Z. Ilir Murtezaj	Pjesëmarrës
AMIK	Z. Shpresim Vranoci	Pjesëmarrës
FMN	Z. Selim Thaqi	Pjesëmarrës
Oda Ekonomike e Kosovës	Znj. Eralda Kurtaj	Pjesëmarrës
ASHI	Z. Genc Hamzaj	Pjesëmarrës
Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit-MINT	Z. Nijazi Shala	Pjesëmarrës
Agjencia për Regjistrim Civil	Z. Xhavit Gubetini	Pjesëmarrës
Visa	Znj. Snezana Sofijanic Znj. Tamara Gavrilovic	Pjesëmarrës
Master Card	Znj. Silvia Hadzhiyaneva	Pjesëmarrës

² Anëtarët e KKP-së, përfaqësues nga Institucionet Financiare Jo-Bankare, janë anëtarë të caktuar për përfaqësim në këtë takim. IFJB-të duhet të caktojnë dhe informojnë BQK për anëtarët me të drejtë vote, për takimet e ardhshme në pajtim me Udhëzimin për KKP.

	Znj. Vanya Manova	
Banka Botërore	Znj. Oya Pinar Z. Holti Banka Z. Bernardo Barradas Z. Peter Jensen Znj. Edlira Dashi Z. Andrea Monteleone	Pjesëmarrës
Bankat Komerçiale	Z. Florent Lila – RBKO Z. Visar Paçarada – PCB Z. Orcun Ozdemir – TEB Z. Gazmend Rrustemi – BpB Z. Shpend Luzha – BE Znj. Arta Mirashi – IsBanka Z. Kenan Bozkurt – Ziraat Z. Fisnik Behxheti – Pribank Znj. Arnuela Aliko - Credins Banka NLB- NLB	Pjesëmarrës
IFJB	Z. Burim Geci – Posta e Kosovës Z. Adrian Zylfiu – Moneta (Money Gram) Z. Genc Sheholli – Capital (Ria) Z. Astrit Sallauka – Vllesa Co (Ria) Z. Astrit Dobraj – Finser Znj. Blerina Sadikaj – Paysera Z. Faredin Agaj – Velanis/Swinto Z. Yll Dushi – Onefor Kosovo	Pjesëmarrës
Zyra e EU-së	Znj. Feride Zeka	Pjesëmarrës
Banka Qendrore e Kosovës	Z. Ramadan Matarova Z. Ilir Hasani Z. Ibrahim Krasniqi	Pjesëmarrës